



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202200643/11

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandim për përcaktimin e kohëzgjatjes së trajtimit me medikamente, të të burgosurit në kartelën klinike.*

### IEVP MALËSI E MADHE

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur jeni njohur me ankesën e paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit nga i dënuari B. P. në datën 04.05.2022, i cili pretendonte se ishte i sëmurë kronik dhe për këtë arsye kishte kërkuar të vizitohet nga mjeku i IEVP-së, por kjo kërkesë nuk ishte realizuar.

Për verifikimin e kësaj ankese nga ana jonë iu kërkuar shpjegime IEVP Malësi e Madhe si dhe u administrua fotokopje e kartelës klinike të të dënuarit B. P.

Referuar përgjigjes së marrë nga IEVP Malësi e Madhe me shkresën Nr.3009/1 Prot., datë 17.06.2022 dhe shënimeve të lëna në kartelën klinike me nr. 53 rezulton se:

I dënuari B. P. ka kryer në datën 14.11.2018 konsultë me mjekun specialist alergolog, i cili ka lënë shënim se dyshon për rinit alergjik, por nuk ka dhënë mjekim. Po në këtë datë i dënuari ka kryer konsultë me mjekun neurolog, i cili nuk ka konstatuar probleme.

Gjithashtu, në datën 05.12.2019 i dënuari ka kryer konsultë me mjekun pneumolog, i cili nuk ka konstatuar probleme akute. Në këtë rast është dhënë mjekim me shurup Bromexinë 3x1. Po në këtë datë i dënuari ka kryer konsultë me mjekun psikiatër, të cilit i është ankuar se nuk mbushej dot me frymë gjatë natës, i rritej tensioni, kishte humbje oreksi, mbushej me djersë dhe për këtë arsye përdorte Nafazolinë në vazhdimësi. Mjeku psikiatër ka shënuar se i dënuari ka realizuar konsulta me mjekë specialist ORL, alergolog dhe pneumolog dhe nuk ka rezultuar me probleme organike. Diagnoza e vendosur nga mjeku psikiatër është: *çrregullim ankthi të somatizuar* për t'u trajtuar me medikamentet: Fevarin 1x1; Olanzapine ¼ tbl.

Ndërsa, në datën 24.03.2020 i dënuari ka kryer konsultë me mjekun e institucionit, të cilit i është ankuar për bllokim të frymëmarrjes dhe ka kërkuar shtimin e dozës së Diazepamit.

Në përgjigjen e lartpërmendur thuhet se, trajtimi mjekësor i të dënuarit B. P. në vijim do të jetë sipas gjendjes shëndetësore dhe ndërkohë ai vazhdon të marrë terapinë me Nafazolinë që sigurohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Mbi bazën e këtij informacioni i kemi kthyer përgjigje të dënuarit B. P., i cili pasi u njoh me të ka pretenduar si të pavërteta të dhënat e paraqitura nga ana IEVP-së duke u shprehur se nuk janë marrë për bazë shqetësimet e referuara prej tij dhe se medikamentin Nafazolinë e blen me shpenzimet e veta. Më konkretisht, i dënuari B. P. shprehet si më poshtë vijon:

*“Nuk marr frymë dot. Rri natën pa fjet, sepse më ikën frymarrja. Hundët e bllokuara, nuk kam forcë fare. Vuaj nga tretja, kam dhimbje gjoksi, kam dhimbje veshkash, marrje mendsh, humbje ekuilibri, skuqje sysh, irritim, djegie fytyre. Nafazolinat e blej vet, nuk mi jep burgu”.*

Në vijim të verifikimit të kësaj ankese, me shkresat Nr.K2/B4-7 Prot., datë 10.10.2022 dhe Nr.K2/B4-9 Prot., datë 31.10.2022 ju drejtuam sërish IEVP Malësi e Madhe me kërkesë për t'u informuar se kur nga ana e stafit mjekësor është rekomanduar që i dënuari B. P. të trajtohet me medikamentin Nafazolin dhe për sa kohë.

Në përgjigjen tuaj ardhur me shkresat Nr.6205/1 Prot., datë 19.10.2022 dhe Nr.6205/3 Prot., datë 17.11.2022 thuhet se: në kartelën klinike të të dënuarit B. P. është shënuar më datë 14.10.2019 “mjekim me nafazolinë”, të dhënë nga mjeku i institucionit që ka qenë në detyrë në atë kohë. Medikamenti Nafazolin i është dhënë të dënuarit B. P. sipas gjendjes së furnizimit në farmacinë e IEVP-së dhe me kujdes në sasi, pasi përdorimi i tepruar krijon çrregullime. Ky medikament nuk rimburohet, kështu që i dënuari duhet ta sigurojë vetë. Meqenëse në farmacinë e IEVP-së ka në gjendje nga ky medikament, ai do t'i jepet të dënuarit sipas nevojës.

Për sa i përket përdorimit të medikamentit Nafazolin, nga informacioni dhe dokumentacioni i dërguar rezulton se ai i është siguruar të burgosurit, por nga ana e mjekut të IEVP-së nuk është përcaktuar kohëzgjatja e përdorimit të këtij medikamenti si dhe nuk janë lënë rekomandime për kontrole të mëtejshme pas përfundimit të kurës.

Sikurse pranohet edhe në përgjigjet që kemi marrë nga ana juaj, përdorimi i tepruar i këtij medikamenti krijon çrregullime.

Referuar Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve, në zbatim të nenit 4/2/b dhe nenit 20 të Ligjit Nr.123/2014 “*Për urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë*”, në këto akte përcaktohen qartë rregullat lidhur me shënimet që lihen në kartelën klinike.

Më konkretisht, për rastin në fjalë referojmë në nenin 23, pika 1 të VKM Nr. 209, datë 06.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, ku parashikohet se:

*“Pas vizitave ekzaminuese, mjeku i institucionit ose mjeku specialist sipas llojit të sëmundjes së të burgosurit, përcakton mjekimin e nevojshëm, që shënohet në regjistrin e vizitave mjekësore dhe kartelën klinike shëndetësore, si dhe i jep rekomandimet përkatëse personelit shëndetësor për veprime të mëtejshme”*,

Më tej, në nenin 34 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore përcaktohet se:

*“Të gjitha veprimet diagnostikuese e mjekuese që kryen në praktikën klinike në çdo lloj shërbimi dhe profili ambulator, spitalor, publik a privat, mjeku i përshkruan (regjistron) në dokumentet mjekësore të posaçme, të cilat ruhen e mirëmbahen në përputhje me dispozitat që aplikon institucioni shëndetësor në kushtet e respektimit dhe të ruajtjes së sekretit profesional.*

*Mjeku e ka për detyrë të krijojë Dosjen (kartelën) klinike individuale të të sëmurit, e cila plotësohet dhe ruhet nën përgjegjësinë e mjekut kurues si një dokument i rëndësishëm klinik, studimor-shkencor dhe juridik (mjeko-ligjor). Ai e ka për detyrë të përshkruajë në kartelën klinike qartë e kuptueshëm diagnozat, ekzaminimet dhe interpretimet e tyre, mjekimet dhe argumentet për çdo ndryshim që bën, si dhe konsultat mjekësore që kryhen për të sëmurin e tij”.*

Ndërsa, sipas vlerësimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut<sup>1</sup>, thjesht fakti që një i burgosur vizitohet nga një mjek dhe është përshkruar një formë e caktuar e trajtimit nuk mund të çojë automatikisht në përfundimin se ndihma

---

<sup>1</sup> Guide on the case-law of the European Convention on Human Rights, “Prisoners’ rights”, European Court of Human Rights, updated on 31 August 2022, pg. 29.  
[https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Prisoners\\_rights\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Prisoners_rights_ENG.pdf)

mjekësore është adekuate (Hummatov kundër Azerbajxhanit, 2007, § 116). Autoritetet gjithashtu duhet të sigurojnë që të mbahen të dhëna gjithëpërfshirëse në lidhje me gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit dhe trajtimit të tij gjatë qëndrimit në paraburgim (Khudobin kundër Ruisë, 2006, § 83), se diagnoza dhe kujdesi janë të menjëhershëm dhe të saktë (Melnik kundër Ukrainës, 2006, §§ 104-106).

Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se në rastet kur kërkohet për nga natyra e gjendjes shëndetësore, mbikëqyrja mjekësore duhet të jetë e rregullt dhe sistematike dhe përfshin një terapi gjithëpërfshirëse që synon trajtimin e duhur të problemeve shëndetësore të të paraburgosurit ose parandalimin e përkeqësimit të tyre, në vend të trajtimit mbi baza simptomatike (Amirov kundër Ruisë, 2014, § 93).

Në vlerësimin tonë, procedura e përcaktimit të mjekimit të nevojshëm, të kohëzgjatjes së përdorimit të medikamenteve si dhe rekomandimeve të nevojshme për kontrolle apo veprime të mëtejshme, duhet të zbatohet në të gjitha IEVP-të për të mos lënë mundësi për të mos sjellë asnjë pasojë në gjendjen shëndetësore të të burgosurve apo dhe që të ngrihen pretendime, qoftë nga të burgosurit apo familjarët e tyre. Ndjekja e saj me rigorozitet do ta bënte efektive të drejtën e të burgosurve për shërbime dhe kujdes shëndetësor, si një nga garancitë e parashikuara në aktet ligjore që lidhen me trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve. Ndaj do të duhet të merren masat e nevojshme për të adresuar gjetjet tona në funksion të përmirësimit të praktikës së përshkrimit të veprimeve dhe konstatimeve të stafit mjekësor në dokumentet mjekësore.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime*

*për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”.*

### **REKOMANDOJMË:**

- Marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e procedurës që duhet të ndiqet nga stafi mjekësor i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për përcaktimin e kohëzgjatjes së përdorimit të medikamenteve si dhe rekomandimeve të nevojshme për kontrole apo veprime të mëtejshme në kartelën klinike të të burgosurit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**